



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNIK

KOMITETI I AUDITIMIT – AUDIT COMMITTEE – ODBOR ZA REVIZIJU

STATUTI I KOMITETIT TË AUDITIMIT NË PRESIDENCË

Prishtinë, më 31.12. 2019.



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

KOMITETI I AUDITIMIT – AUDIT COMMITTEE – ODBOR ZA REVIZIJU

Komiteti i Auditimit në Presidencë,

Në mbështetje të nenit 6 (4) të Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik (11.02.2019), në takimin e mbajtur më 26.12.2019, miraton:

STATUTIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT NË PRESIDENCË

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohet përbërja, pjesëmarrja në takime, orari, shpeshësia e takimeve, autoriteti, detyrat dhe procedurat e raportimit të Komitetit të Auditimit në Presidencë.

Neni 2
Fushëveprimi

Statuti zbatohet nga Komiteti i Auditimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm, si dhe njësitë tjera përkatëse të Presidencës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë këtë kuptim:

- 1.1. **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Presidencë** – Selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit, që përfshin Kabinetin e Presidentit, Zyrën e Presidentit dhe institucionet/njësitë tjera të ndërlidhura;
 - 1.3. **Komiteti i Auditimit** – Komiteti i Auditimit në Presidencë;
 - 1.4. **Kryesuesi** – Kryesuesi i Komitetit të Auditimit;
 - 1.5. **NJAB** – Njësia e Auditimit të Brendshëm në Presidencë;
 - 1.6. **Sekretar** – Sekretari i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.7. **Zyrë** – Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.8. **Udhëzim** – Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik (11.02.2019).
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Statut kanë kuptimin e njëjtë sikurse në Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (GZ, nr. 3, 19 prill 2018).

KAPITULLI II – KOMITETI I AUDITIMIT NË PRESIDENCË

Neni 4

Përbërja e Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit i themeluar me Vendimin e Presidentit, Nr. 257/2019 (15.10.2019), përbëhet nga tre (3) anëtarë, dy (2) nga të cilët janë të jashtëm dhe një (1) nga stafi i brendshëm i Presidencës.
2. Mandati i Komitetit të Auditimit është tre (3) vjeçar, me të drejtë të riemërimit, por jo më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme.

Neni 5

Pjesëmarrja, orari dhe shpeshësia e takimeve të Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit mbanë së paku katër (4) takime në vit.
2. Komiteti i Auditimit mban së paku një (1) takim në çdo periudhë tremujore të vitit.
3. Presidenti, mund të kërkojë mbajtjen e takimeve të tjera për të diskutuar çështje të caktuara, për të cilat kërkojnë këshilla nga Komiteti i Auditimit.
4. Kryesuesi mund të thërras takime shtesë, sipas vlerësimit të tij apo anëtarëve të Komitetit të Auditimit.
5. Takimet e Komitetit të Auditimit ftohen nga Kryesuesi.
6. Kryesuesi dhe Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit dhe në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
7. Drejtori i NJAB ftohet në takimet e Komitetit të Auditimit, më përjashtim kur Komiteti i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performancën e NJAB-it.

8. Kur është e nevojshme, Komiteti i Auditimit mund të ftojë edhe zyrtarët dhe personat tjerë me kualifikim adekuat për të marrë pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit. Zyrtari kryesor financiar dhe Drejtori i NJAB-it në Presidencë ofrojnë mbështetje për Komitetin e Auditimit, atëherë kur është e nevojshme dhe kur kërkohet nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit.
9. Takimi i Komitetit të Auditimit, mbahet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve.
10. NJAB ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit.

Neni 6

Procesverbali i takimit

1. Për çdo takim të Komitetit të Auditimit mbahet procesverbal.
2. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e diskutimit, data dhe vendi i takimit, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen dhe konkluzionet e arritura.
3. Procesverbali, pas nënshkrimit nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit, i përcillet për njoftim Presidentit.

Neni 7

Autoriteti

1. Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për Presidentin dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.
2. Komiteti i Auditimit në Presidencë, funksionon në bazë të kritereve të vendosura nga Ministri përgjegjës për Financa dhe ushtron autoritet, si në vijim:
 - 2.1. ndihmon Presidentin në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime për Presidentin që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm; dhe
 - 2.2. mbështet NJAB për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve, operacionet e të cilëve auditohen dhe për të siguruar që rekomandimet e auditorit janë trajtuar si duhet nga Presidenti.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit në Presidencë, të përcaktuara në nenin 7 të Udhëzimit, janë si në vijim:
 - 1.1. këshillon Presidentin për çështjet që kanë të bëjnë me:
 - 1.1.1. themelimin dhe zhvillimin e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të financave publike;
 - 1.1.2. vlerësimin e rrezikut;

- 1.1.3. menaxhimin e rrezikut; dhe
- 1.1.4. përshtatshmërinë e burimeve të aktivitetit të auditimit për të realizuar me sukses planin e auditimit;
- 1.2. siguron marrëdhënie efektive dhe bashkëpunuese ndërmjet Presidentit, zyrtarit kryesor financiar, NJAB dhe auditorit të jashtëm;
- 1.3. miraton statutin e auditimit të brendshëm;
- 1.4. shqyrton dhe miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, pa pasur kompetenca drejtuese për këto dokumente;
- 1.5. mbikëqyr dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit të miratuar përmes raporteve periodike nga Drejtori i NJAB;
- 1.6. siguron që mashtrimet e mundshme ose korrupsioni i dyshuar, të identifikuar nga raportet e auditimit të brendshëm ose të sjellë ndryshe në vëmendjen e Komitetit të Auditimit, të raportohen tek autoritetet kompetente;
- 1.7. shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga Presidenti;
- 1.8. shqyrton raportet e rregullta mbi statusin e zbatimit të planeve të veprimit të miratuara nga Presidenti që rezultojnë nga auditimet e mëparshme të brendshme dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm;
- 1.9. shqyrton pasqyrat financiare dhe opinionet e raporteve të auditimit të jashtëm; dhe
- 1.10. shqyrton raportin vjetor për aktivitetet e NJAB para se të dorëzohet e njëjta në Njësinë qendrore harmonizuese në Ministrinë e Financave.

Neni 8

Procedurat e raportimit

1. Komiteti i Auditimit përgatit raporte tre (3) mujore, vjetore, sipas nevojës dhe më kërkesë të Presidentit.
2. Komiteti i Auditimit mund të mban takime me Presidentin, zyrtarin kryesor financiar, auditorët e brendshëm dhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit, ku diskuton për raportet përmbledhëse periodike tre (3) mujore, vjetore, sipas nevojës dhe më kërkesë të Presidentit, lidhur me aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe jashtëm dhe menaxhimin financiar e kontrollin.
3. Komiteti i Auditimit i shqyrton raportet e diskutuara në takimet e mbajtura me akterët e ndryshëm dhe të njëjtat i përcjell tek Presidenti, ku në këto raporte janë të përmbledhura aktivitetet e ndërmarra dhe ofrimi i këshillave për veprimet e mëtejshme.
4. Raporti tre (3) mujor i Komitetit të Auditimit, përmban përmbledhjen e aktiviteteve të:
 - 4.1. auditimit të brendshëm; dhe
 - 4.2. auditimit të jashtëm.
5. Raporti Vjetor i Komitetit të Auditimit, siç përcaktohet në nenin 10 (1) të Udhëzimit, përmban:
 - 5.1. përshtatshmërinë e mjedisit të kontrollit të brendshëm, për të siguruar funksionim

- efektiv, efikas dhe të ligjshëm;
- 5.2. përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe mënyrat e eliminimit të tyre;
 - 5.3. pozitën financiare të Presidencës, përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportimin e subjektit të sektorit publik;
 - 5.4. ndonjë dështim madhor të sistemit që vë në rrezik Presidencën;
 - 5.5. pavarësinë e auditorit dhe efektivitetin e NJAB;
 - 5.6. efikasitetin e NJAB:
 - 5.6.1. në shqyrtimin e menaxhimit të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm; dhe
 - 5.6.2. në dhënien e rekomandimeve praktike tek Presidenti për përmirësimin e tyre;
 - 5.7. përshtatshmërinë e veprimeve të Presidentit të ndërmarra për adresimin e rekomandimeve të NJAB dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit; dhe
 - 5.8. përmbledhjen e punës së Komitetit të Auditimit.
6. Raporti sipas nevojës i Komitetit të Auditimit, duhet të përmban në mënyrë të përmbledhur çështjen specifike të trajtuar lidhur me aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe jashtëm dhe menaxhimin financiar e kontrollin në Presidencë.
7. Raporti më kërkesë të Presidentit, i Komitetit të Auditimit, përmban në mënyrë të përmbledhur çështjen për të cilën kërkohet të raportohet lidhur me aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe jashtëm dhe menaxhimin financiar e kontrollin në Presidencë.
8. Raportet tre (3) mujore të Komitetit të Auditimit i dorëzohen Presidentit, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të periudhës tre (3) mujore.
9. Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit i dorëzohet Presidentit, më së largu deri me 31 mars, të vitit vijues.
10. Raportet e Komitetit të Auditimit sipas nevojës dhe më kërkesë të Presidentit, i dorëzohen Presidentit, në një afat sa më të shkurt.

KAPITULLI III - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9 Buxheti

Sekretari siguron buxhetin e nevojshëm, për punën, angazhimin, pjesëmarrjen në takime si dhe funksionimin e përgjithshëm të Komitetit të Auditimit.

Neni 10 Dorëheqja e kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit mund të japin dorëheqje nga Komiteti i Auditimit.

2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit e njoftojnë Presidentin për dorëheqjen e ofruar.
3. Anëtari që jep dorëheqje duhet të kryej të gjitha detyrat deri në caktimin e anëtarit të ri nga Presidenti.

Neni 11

Shkarkimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit

1. Presidenti me Vendim mund t'i shkarkojë Kryesuesin dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit nëse:
 - 1.1. kryesuesi apo anëtari i Komitetit të Auditimit ka treguar performancë të dobët;
 - 1.2. është dënuar për veprë penale nga Gjykata Kompetente;
 - 1.3. kërkohet nga Komiteti i Auditimit që të bëjë shkarkimin.
2. Komiteti i Auditimit me shumicë votash mund ta kërkojë nga Presidenti që të shkarkojë secilin anëtar duke përfshirë edhe kryesuesin e Komitetit të Auditimit, nëse:
 - 2.1. nuk i kryen detyrat që i janë dhënë nga Komiteti i Auditimit;
 - 2.2. keqpërdor dhe/apo neglizhon pozitën e tij si anëtar i Komitetit të Auditimit;
 - 2.3. nuk merr pjesë pa arsye tri (3) herë radhazi në takimet e Komitetit të Auditimit.
3. Në rastet e shkarkimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit, Presidenti emëron anëtarin e ri.

Neni 12

Bashkëpunimi dhe mbështetja e Komitetit të Auditimit

Të gjitha njësitë e Presidencës obligohen që të bashkëpunojnë dhe t'i ofrojnë mbështetje Komitetit të Auditimit, për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

Neni 13

Rishikimi i Statutit

Rishikimi i këtij Statuti, duke përfshirë edhe ndryshim plotësimin e tij, bëhet në mënyrën e njëjtë të miratimit të tij.

Neni 14

Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i Komitetit Auditimit të Brendshëm në Presidencë (datë: 25.01.2018, Nr. Prot.: 112).

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit me Dekret nga Presidenti.

Prishtinë, 31 . 12 .2019

Zijush AHMETI



Kryesues i Komitetit të Auditimit